



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253233
Datë: 20.01.2023
Numri i dokumentit: 03881657

C-IV - 13 – 1833

Paditës: I R nga Gjilani të cilin e përfaqëson av B I nga Prishtina

Kundër

Të paditurës : Ndërmarrja Shoqërore NHN „ Morava e Binçës ” në likuidim të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në Prishtinë, Rr. „ Driton Hoxha ”, nr. 55.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me dt. 16 janar 2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa/kërkesa e paditësit.**
- II. NDRYSHOHET Vendimi i Autoritetit Likuidues GJI 037 - 0192 , dt. 21.08.2013, ashtu që obligohet e paditura NSH N „ M e B ” që paditësit I R për kontributin pensional, t’ ia paguaj shumën 731.00€ e cila shumë paguhet në Trust të Kursimeve të Kosovës, sipas nenit 40 pika 1.6.1, të Shtojcës së ligjit nr. 04/L-034.**
- III. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 26. 09.2013, pranë DHPGJS është parashtruar ankesa/ kërkesa e paditësit përmes avokatit B I nga Prishtina, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH N „ M e B ” GJI 037-0192 , më 21.08.2013, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e kontributit pensional në shumën 731.00 €, për periudhën 2002- 2010 .

Në ankesë ka propozuar që Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, të anulohet dhe të aprovohet kërkesa e ankuesit në tërësi dhe të obligohet e paditura të paguaj për punëtorin kontributin pensional .

Kësaj parashtrëse ja ka bashkangjitur :

- Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI037- 0192.

Më dt. 12.01.2018, AKP-ja, përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje, ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të AL GJI 037- 0192 ,me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet Vendimi .

Në parashtrësë është deklaruar se NSH NHN „M e B ” është në procedurë të likuidimit nga data 03.06.2013, ndërsa më dt. 18.07.2013, parashtruesi ka dorëzuar kërkesën përmes të cilës ka kërkuar kompensimin për kontributin në pension në shumën 731.00€ për periudhën 2002- 2010.

Autoriteti i Likuidimit mori Vendimin GJI 037- 0192, dt. 23.08.2013, me të cilin ka refuzuar kërkesën.

Vendimi i AL mbështetet në fatet dhe bazat ligjore në vijim :

- Neni 37.9.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/l-034, parashikon „Përveç bazave të tjera për refuzimin e kërkesës , Autoriteti i Likuidimit gjithashtu ka të drejtë , pa kufizime që të kundërshtojë një kërkesë në tërësi apo pjesërisht bazuar në faktin që kërkesa është përmbushur në mënyra të tjera ”
- Vendimi i Gjykatës Komonale në Gjilan C. nr. 458/2009, dt. 30.12.2011, nuk është i formës së prerë .
- Sipas paragrafit 2 a dhe 2 b të nenit 6 të Ligjit 04/L-101 , punëdhënësi do të paguaj një shumë të barabartë me 5% të rrogave të përgjithshme të punonjësve dhe çdo punonjësi paguan një shumë e barabartë me 5%, të pagave totale . Sipas paragrafit 3 të këtij nenin punëdhënësi zbrit kontributin e punonjësit nga rroga e punonjësit dhe e bartë në llogari të posaçme të fondit.
- Si rrjedhojë çdo shumë e pranuar në lidhje me kontributet pensionale do të paguhet drejt për drejt T të K dhe jo Parashtruesit.

Më dt. 02.02.2018, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te i padituri nga data 08.04.1986 e deri më dt. 09.05.2008, paditësit nuk ju janë paguar kontributet pensionale në shumën 731.00€, dhe kërkesa është refuzuar nga AL. Kërkesa e paditësit dhe e punëtorëve të tjerë është miratuar nga Gjykata Komonale në Gjilan me aktgjykimin, C. nr. 458/2009, dhe është detyruar e paditura të paguaj shumën 731.00 €.

Kësaj parashtrëse ja ka bashkangjitur :

- Kopjen e Librezës së punës
- Kopjen e Aktgjykimit C. nr. 458/2009, dt. 30.12.201, të Gjykatës Komonale në Gjilan dhe
- Vendimi i AL GJI 037- 0192.

Më dt. 01.03.2018, AKP-ja ka dorëzuar parashtrësën ndaj përgjigjes së të autorizuarit të paditësit me të cilën është deklaruar se mbesim pran qëndrimin në përgjigje në ankuesë . Më tej ka theksuar se Parashtruesit nuk ju është refuzuar kërkesa kërkesa do të përmbushet ndaj ATK-së, në bazë të Ligjit nr. 04/L101 . Ankesa është e pa bazuar .

Arsyetimi Ligjor

Ankesa/ kërkesa e paditësit , është e bazuar .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar provat të cilat i ka ofruar paditësi, dhe pretendimet në kërkesë si dhe pretendimet e të paditurës në parashtrësë të mbrojtjes dhe provat , ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtor i të paditurit N „M e B ” , por si kontestuese është për të paditurën mënyra e pagesës së kontributit pensional të paditësit, pasi sipas të paditurit, kjo shumë paguhet në Fond , Trust, e jo në llogari të paditësit .

Nga përmbajtja e pretendimeve në parashtrësë të paditurit konstatohet se nuk është kundërshtuar lartësia e shumës së kontributit, shuma 731.00€ .

Me Aktgjykimin C. nr. 458/2009, të Gjykatës Komonale në Gjiilan ku si paditës ka qen edhe paditësi me nr. rendor 266 IR, të njëjtit ju është gjykuar shuma e kontributit pensionale 731.00€.

Ky aktgjykim nuk ka dëshmi se është bërë i formës së prerë, sikundër nuk ka dëshmi se e paditura NSH, të cilën e ka përfaqësuar AKP-ja me përfaqësuesin e saj Xh S, të ketë ushtruar ankesë kundër Aktgjykimit.

Me Vendimin AL GJI 037- 0192, është refuzuar Kërkesa e I R për kompensimin e kontributit pensional në shumën 731.00€. Vendimi në fjalë mbështetet në nenin 37.9.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 .

Gjykata vlerëson, Autoriteti i Likuidimit drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike por ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e kontributit në trust, kjo pasi derisa në arsyetim të vendimit thuhet se kërkesa do të shqyrtohet, por nuk do të paguhet parashtruesit (paditësit) të kërkesës drejt për drejtë, por do të paguhet në T të K .

Në rastin konkret , me parashtrësë të përgjigjes në mbrojtje AKP-ja, nuk është deklaruar fare se a' ka vepruar në pagimin e kontributeve për pension të punëtorëve, por vetëm është deklaruar se këto kërkesa paguhet në Trust .

Nisur nga kjo rrethanë, e zbatimit të gabuar të drejtës materiale nga ana e AKP-së kur e ka refuzuar kërkesën, gjykata vlerëson se edhe kërkesa për pagesa të kontributeve pensionale është pjesë e kërkesës për pagesa të pagave, kështu që për nga prioriteti i pagesave kontributet hyjnë në prioritetin e paraparë me nenin 40 .1.6.1, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Në rasatin konkret, gjykata vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar , dhe se u vendos të ndryshohet Vendimi i AL GJI 037- 0192, ashtu që është pranuar kërkesa për kompensimin e kontributit pensional në shumën 731.00€, por që kjo shumë do të paguhet në Trust të Kursimeve të Kosovës .

Gjykata me rastin e pranimit të kërkesës së paditësit për pagesën e kontributit pagat e pa paguara, ka zbatuar dispozitën e nenit 40 paragrafi 1, pika 1.6.1 të Shtojcës së Ligjit, nr. 04/L-034 .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e procedurës gjyqësore .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva

Gjyqtar